



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

## KONTRATË PUBLIKE

### FURNIZIM

Titulli: "Furnizim me materialin e shtypur për Inspektoratet"

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 206-24-3380-1-3-6/C556

Numri i Prokurimit: 206-24-3380-1-3-6

**MEDIATECH & PRINT SH.P.K**

**NUI: 810839425**

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Numri i kontratës <sup>2</sup>: 206-24-3380-1-3-6/C556

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe  
**MEDIATECH & PRINT SH.P.K., TREGU ME SHUMICË TE AMORTIZATORËT, PRISHTINË**,  
(në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

**Furnizim me materialin e shtypur për Inspektoratet me numër identifikues: 206-24-3380-1-3-6**

#### **Neni 1 Lënda**

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim;
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin nga të dyja palët dhe përfundon pas 2 muajve.

<i>Nr.</i>	<i>Grupi</i>
1	Furnizim me materialin e shtypur për Inspektoratet

#### **Neni 2 Kushtet e dërgesës**

- 2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **10 ditë** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.
- 2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: **Objekti i Inspektoratit Shëndetësor dhe Sanitar.**
- 2.3 Inkotermi<sup>3</sup> i zbatueshëm do të jetë DDP<sup>4</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

#### **Neni 3 Origjina**

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

#### **Neni 4 Çmimi**

- 4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **2,557.00 €**; [dymijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë] Euro.
- 4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.
- 4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.
- 4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

<sup>2</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

<sup>3</sup> Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

<sup>4</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare



Nr.	Emertimi i Artikullit	Njësia	Sasia	ÇMIMI PËR NJËSI PA TVSH €	TVSH (%)	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1	Furnizim me blloka A4 - Procesverbale për inspektim Blloka A4 100 fletë 60 gr. Duke përkruar numrin serik, faqja e parë e bardhë dhe tri faqe me ngjyra te ndryshme (indigo). Dizajnin dhe përmbajtjen e përcakton Autoriteti Kontraktues.	Blloka/copë	1500	1.008	18	1.19	1,785.00€
2	Furnizim me blloka A4 - Vendime për shqiptimin e gjobave kundervajtëse për inspektim Blloka A4 100 fletë 60 gr. Duke përkruar numrin serik, faqja e parë e bardhë dhe tri faqe me ngjyra te ndryshme (indigo). Dizajnin dhe përmbajtjen e përcakton Autoriteti Kontraktues.	Blloka/ copë	500	1.008	18	1.19	595.0€
3	Stikersa i formatit A4 me ngjitës, materiali duhet të jetë plastik i cili nuk e dëmton uji dhe shërben për mbyllje te përkohshme të subjekteve	Cope	1,000	0.076	18	0.09	90.00€
4	Paragon blloka- Blloka A5 100 fletë 60 gr. Duke përkruar numrin serik, faqja e parë e bardhë dhe tri faqe me ngjyra te ndryshme (indigo). Dizajnin dhe përmbajtjen e përcakton Autoriteti Kontraktues.	Copë	300	0.246	18	0.29	87.00€
<b>Totali (DDP):</b>							<b>2,557.00€</b>

## Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe <sup>5</sup> në dy origjinale, një prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Menaxheri i kontratës është: znj. Floriana Latifi

Telefoni: 044259047

E-mail: Floriana.Latifi@rks-gov.net



Personi kontaktues nga OE: KALTRINA GASHI


Telefoni: 049/589845

E-mail: INFO@MEDIATECH-PRINT.COM

**Për Autoritetin Kontraktues**

**Për Furnizuesin**

<b>Emri:</b>	Berat Marmullaku	<b>Emri:</b>	MERGIA DILLURI
<b>Pozita:</b>	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	<b>Pozita:</b>	PERFAQES LIGJOP
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	30.04.2024	<b>Data:</b>	30.04.2024
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	



<sup>5</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.